



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2025

Raporti i nënshkuar nga

Vlora Spanca,

Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vitisë (K.V), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Vitisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Pagesat në vlerë prej 2,817,932€ janë klasifikuar gabimisht në kategori të ndryshme ekonomike, si pasojë e ekzekutimit të vendimeve përmbartimore/gjyqësore. Këto keqklasifikime përfshijnë kategoritë e mallrave dhe shërbimeve, shpenzimeve komunale, subvencioneve dhe transfereve, si dhe investimeve kapitale. Po ashtu, në kuadër të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve janë evidentuar 639,359€, të cilat janë klasifikuar gabimisht, pasi që sipas natyrës i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve.
- A1 Në katër raste, pasuritë e pranuar përmes marrëveshjeve të mirëkuptimit, me vlerë totale prej 2,260,313€, nuk janë regjistruar në regjistrin e pasurive të Komunës.
- B2 Janë evidentuar se 14 pasuri në vlerë 1,298,642€, të ndërtuara gjatë viteve 2013–2020 dhe gjashtë pasuri të përfunduara gjatë viteve 2024–2025 në vlerë 2,112,674€ të cilat mbahen si investime në vijim, përderisa ato janë në shfrytëzim për tu klasifikuar si pasuri në përdorim.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Vitisë kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Komuna e Vitisë ka lidhur Kontratë Publike Kornizë për shërbime profesionale në vlerë prej 708,328€, përmes së cilës janë angazhuar 106 punëtorë, ndonëse natyra e këtyre shërbimeve përkon me detyrat që kryhen nga stafi i rregullt i komunës. Përveç kësaj, janë identifikuar edhe dobësi në procesin e realizimit të kontratës pasi që janë tejkaluar sasisë indikativ për 34,540 shërbime apo në vlerë financiare 88,397€.
- A3 Janë evidentuar mangësi sa i përket pranimi të furnizimeve në vlerë 23,933€, pra, janë bërë nga menaxheri i kontratës dhe jo nga komisioni prej tre anëtarësh siç kërkohet me rregullativën ligjore.
- B3 Ridestnimi i mjeteve financiare prej 40,000€ ishte bërë pa miratimin e Kuvendit Komunal, për një projekt kapital.
- B4 Komuna nuk kishte arritur të paguaj faturat brenda afatit prej 30 ditësh. Janë identifikuar 26 fatura në vlerë prej 834,857€, ku pagesat nuk janë realizuar brenda afatit ligjor, me vonesa deri në 405 ditë.
- A4 Komuna nuk ka formuar komisionin për realizimin e inventarizimit vjetor të pasurisë jo financiare, në përputhje me kërkesat ligjore.
- B5 Janë evidentuar mangësi gjatë procesit të subvencionimit të fermerëve me mekanizëm bujqësor. Thirrja publike nuk ishte realizuar sipas rregullores në fuqi. Për më tepër, në katër raste përfituesit nuk i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara për hapsiren minimale të kulturave të mbjellura.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Vitisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Vitisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Vitisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Vitisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare,

lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Vitisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 13 rekomandime, prej tyre 5 janë rekomandime të reja dhe 8 të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Keqklasifikim i shpenzimeve në kategorinë ekonomike

Gjetja

Sipas nenit 18, pika 3 e Rregullës financiare nr. 01/2013, shpenzimet duhet të regjistrohen në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, që të sigurojnë se të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Gjatë vitit 2025, pagesat në vlerë totale prej 2,817,932€ nuk janë klasifikuar në kategoritë e duhura ekonomike. Keqklasifikimet kanë ndodhur si rezultat i ekzekutimit të vendimeve përmbarimore / gjyqësore që rrjedhin nga kontrata kolektive, të cilat sipas natyrës së tyre i përkasin kategorisë së pagave dhe mëditjeve. Megjithatë, këto pagesa janë realizuar nga kategori të ndryshme buxhetore, si më poshtë:

- 1,735,002€ janë paguar nga kategoria e Investimeve Kapitale;
- 776,609€ janë paguar nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve;
- 203,484€ janë paguar nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve; dhe
- 102,837€ janë paguar nga kategoria e Shpenzimeve Komunale.

Për më tepër, gjatë vitit, Komuna përmes procedurave të prokurimit kishte kontraktuar shërbime dhe kishte realizuar pagesa nga kategoria mallra dhe shërbim, për punëtorët që sipas natyrës i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve. Si rezultat, është evidentuar keqklasifikim i shpenzimeve në vlerë prej 639,359€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme në procesin e planifikimit buxhetor, si dhe vonesave në pagesën e obligimeve në kohë.

Ndikimi

Keq klasifikimi ndikon në mbivlerësim/nënvlerësim e shpenzimeve në kategoritë ekonomike duke shkaktuar prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në Pasqyrat Financiare Vjetore.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike adekuata në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në raportin vjetor financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A1 - Mosregjistrimi i pasurisë së pranuar përmes transferimit ndërinstitucional

Gjetja	Sipas Rregullores së MF – Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 6.3 Pasuria kapitale regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet regjistrohen në sistemin “e-pasuria”. Gjithashtu sipas kësaj rregulloreje, neni 8.1 Pranimi i pasurisë jo financiare bëhet nga blerja, ndërtimi, dhurimet dhe transferet nga organizatat tjera buxhetore. Nga shqyrtimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit dhe marrëveshjeve për transferimin e pasurive është konstatuar se në katër raste pasuritë e pranua përmes transferimeve ndërinstitucionale, me vlerë totale prej 2,260,313€, nuk janë regjistruar në regjistrin e pasurive të Komunës, duke rezultuar në nënvlersimin e pasurive në vlerë prej 2,225,138€ dhe zhvlerësimin e akumuluar në vlerë prej 35,175€. Pasuritë e pranua përmes transfereve ndërinstitucionale dhe të paregjistruara në regjistrin e pasurive të Komunës përfshijnë: • Projekti për zbatimin e masave të efijencës së energjisë në vlerë prej 311,736€, të transferuar nga Ministria e Ekonomisë; • Projekti për Parkun Industrial Budrikë në vlerë prej 1,709,281€, të transferuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; • Projekti për Zbatimin e masave të efijencës së energjisë në vlerë prej 69,939€, të transferuar nga Ministria e Ekonomisë; si dhe • Projektin për inventar në shkolla në vlerë prej 169,357€, të transferuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Kjo kishte ndodhur për shkak mungesës së komunikimit në mes të departamenteve komunale, me rastin e pranimi të pasurive si dhe funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare ndër vite.
Ndikimi	Mosregjistrimi i pasurive ka rezultuar në nënvlerësimin e vlerës së tyre, duke ndikuar në paraqitjen jo të plotë dhe jo të saktë të gjendjes së pasurive dhe raportimit të tyre.
Rekomandimi A1	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë e pranua përmes transferimeve të regjistrohen me kohë, në mënyrë që vlera e pasurive të paraqitet saktë në pasqyrat financiare vjetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Mos mbyllja e investimeve në vijim dhe regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim

Gjetja

Rregullorja nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 11 përcakton që: “Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe vlerësimi”.

Në regjistrin e investimeve në vijim, Komuna ka 14 pasuri në vlerë prej 1,298,642€ të blera (ndërtuara) gjatë viteve 2013-2020, për të cilat nuk është bërë ende pranimi teknik, edhe pse të njëjtat shfrytëzohen nga komuna dhe do të duhej të regjistroheshin si pasuri në përdorim dhe për to të kalkulohej zhvlerësimi. Në mungesë të informatave të sakta për kohën e funksionalizimit të tyre, nuk ka qenë e mundur të përcaktohet vlera e zhvlerësimit të akumuluar e rrjedhimisht edhe vlera neto e pasurive në PVF.

Për më tepër, janë identifikuar katër projekte kapitale, të cilat kishin përfunduar dhe kishin kaluar procedurat e pranimit teknik dhe dy projekte të cilat nuk kishin pranim teknik por ishin në përdorim dhe nuk ishin transferuar nga kategoria "Investime në vijim" në kategorinë "Pasuri në përdorim", të cilat janë paraqitur në vijim:

- Projekti "Revitalizimi i rrugëve Hoxhë Jonuzi dhe Muhamet Muharremi", në vlerë prej 382,736€, për të cilin pranimi teknik është kryer më 22.08.2025;
- Projekti "Ndërtimi i fushave sportive", në vlerë prej 826,941€, për të cilin pranimi teknik është kryer më 20.12.2024;
- Projekti "Rregullimi i kanalizimeve në Komunën e Vitisë", në vlerë prej 407,945€, për të cilin pranimi teknik është kryer më 19.11.2025;
- Projekti "Riparimi i shkollave", në vlerë prej 119,347€, për të cilin pranimi teknik është kryer më 19.06.2025.
- Projekti "Sheshi i qytetit në Viti", në vlerë prej 200,530€, ende nuk kishte përfunduar pranimi teknik. Megjithatë, bazuar në ekzaminimet fizike, u konstatua se sheshi ishte lëshuar për qarkullim dhe shfrytëzohej nga qytetarët.
- Projekti "Ndërtimi i objektit të Njesise së Zjarrëfikësve", me vlerë prej 175,175€, sipas Menaxherit të Projektit është përfunduar, mirëpo për shkak të çështjeve administrative nuk ishte përmbyllur procedura e pranimit teknik.

Si rezultat i mosregjistrimit të këtyre pasurive si pasuri në përdorim, dhe mos kalkulimit të zhvlerësimit të akumuluar pasuritë janë mbivlerësuar për 29,394€.

Mangësitë e identifikuar lidhur me pasurinë e regjistruar si investime në vijim kanë ndodhur për shkak të kontrollit të dobët dhe mos koordinimit të zyrtarit të pasurisë dhe drejtorive përkatëse për investime kapitale në zbatimin e drejtë të rregullores për menaxhimin

e pasurisë.

Ndikimi Mungesa e pranimet teknik për pasuritë e përfunduara që janë në përdorim nga komuna, si dhe mostransferimi me kohë i pasurive të përfunduara nga kategoria "Investime në vijim" në kategorinë "Pasuri në përdorim" ndikon në raportimin jo të saktë dhe të drejtë të pasurive në pasqyrat financiare vjetore.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, përfshirë kryerjen në kohë të pranimet teknik të projekteve të përfunduara dhe regjistrimin e tyre si pasuri në përdorim, me qëllim sigurimin e raportimit të saktë dhe të drejtë në pasqyrat financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Prokurimi i shërbimeve që mund të kryhen nga zyrtarët publikë, mungesa e dëshmive të plota për shërbimet e ofruara si dhe tejkalimi i sasive indikative në kontratën publike kornizë

Gjetja

Sipas nenit 57 të Rregullores nr.001/20022 për prokurimin publik (me plotësim/ndryshime), Procedurat e prokurimit për shërbime të veçanta përdoren për sigurimin e Kontraktorëve Individual për Shërbime të Veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit sipas Ligjit për Zyrtar Publik, rrjedhimisht shërbime të cilat nuk mund të plotësohen me stafin që ka.

Sipas nenit 72A.4 të po kësaj rregulloreje, Menaxheri i kontratës ka përgjegjësinë të bëjë konstatimin e sasisë, cilësisë, llojit dhe vlerës së shërbimeve të pranuar, të cilat dokumentohen me raport përfundimtar se janë në përputhshmëri me kontratën dhe specifikimet e kërkuara.

Përderisa sipas neni 54.10, në Kontratat publike kornizë Autoriteti Kontraktues percakton sasinë indikative të tenderit si një prag apo tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se $\pm 30\%$, e cila vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar Autoriteti Kontraktues nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull.

Gjatë vitit 2025 Komuna e Vitisë kishte lidhur Kontratë Publike Kornizë për “Shërbimet e mbështetjes profesionale me komponentën për ofrimin e shërbimeve publike dhe të mirëqenjes së qytetarëve” për 24 muaj në vlerë prej 708,328€.

Nga rishikimi i dëshmive të pagesave Komuna gjatë vitit kishte angazhuar 106 punëtorë përmes operatorit ekonomik, ndonëse pozitat e tyre, sipas natyrës së punës, duhej të plotësoheshin përmes procedurave të rekrutimit sipas Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe jo përmes kontraktimit të shërbimeve të veçanta. Gjatë auditimit sa i përket procesit të realizimit të kontratës, kemi evidentuar se raporti i pranimit të këtyre shërbimeve është i bazuar në vijueshmërinë/kohën e kaluar në punë të punëtorëve si dhe sasinë e shërbimeve të kryera, i cili përgatitet nga kordinatorja e operatorit ekonomik, por në dosje të pagesës nuk kishte dëshmi që menaxheri i kontratës vërteton sasinë dhe llojin e shërbimit të ofruar.

Për më tepër, kjo kontratë ka të përckatuar sasinë dhe vlerën indikative dhe mundësinë e devijimit $\pm 30\%$ dhe përbën shtatë pozicione, përderisa sipas pagesave për periudhën Mars - Dhjetor 2025 rezulton se në tri pozicione komuna kishte kaluar sasinë

indikative si dhe devijimin prej 30%, për 34,540 shërbime, në vlerë 88,397€ (Pozicioni 1: Shërbimet sociale- tejkalmi 22% apo 27,960€, Pozicioni 2: Shërbimet edukative – tejkalmi 37% apo 47,027 dhe Pozicioni 6: Shërbime në kordinimin e punës – tejkalmi 22% apo 13,410€).

Këto mangësi, sipas komunës ndërlidhen me kufizimet buxhetore në procesin e rekrutimit të punonjësve përmes procedurave të rregullta të punësimit, ndërsa tejkalimet dhe mangësit në menaxhimin e kontratës nga pakujdesia në përmbushjen e kërkesave ligjore.

Ndikimi Mangësitë e identifikuar kanë ndikuar në shmangie të procedurave ligjore të punësimit, rritjen e shpenzimeve komunale, si dhe në realizimin e pagesave të pozicioneve përtej vlerave të përcaktuara në kontratë.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë që planifikimi dhe angazhimi i burimeve njerëzore të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për zyrtar publik, duke shmangur përdorimin e kontratave të shërbimeve për funksione që përfaqësojnë pozita të rregullta pune. Gjithashtu, duhet të forcohen kontrollet gjatë menaxhimit të kontratave publike, me qëllim të parandalimit të tejkalimeve të përcaktuar në kushtet e kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A3 - Mangësi në procedurën e pranimi të furnizimeve

Gjetja Sipas nenit 72A të Rregullores për Prokurim Publik nr.001/2022 me plotësim ndryshimet, Komisioni për pranimin e furnizimeve duhet të jetë në përbërje prej jo më pak se tre (3) anëtarëve nga ekspertë të fushës përkatëse, duke përfshirë edhe menaxherin e kontratës.

Gjatë auditimit kemi identifikuar se pranimi i furnizimeve nuk ishte bere sipas kërkesave te rregullores. Në gjashtë fatura në vlerë totale 23,933€, mallrat ishin pranuar nga menaxheri i kontratës dhe jo nga komisioni prej tre anëtarëve, në përbërjen e së cilit do duhet të ishte edhe menaxheri i kontratës sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Kjo ka ndodhur si pasojë e pakujdesisë në respektimin e kërkesave ligjore të procedurave të përcaktuara për menaxhimin kontratës dhe pranimin e furnizimeve.

Ndikimi Kjo ndikon në uljen e besueshmërisë së procesit të pranimi dhe rrit

rrezikun që furnizimet të pranohen pa verifikim të duhur të përputhshmërisë me kontratën.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë që përbërja e komisioneve për pranimin e furnizimeve të jetë në përputhje me kërkesat ligjore, duke përfshirë menaxherin e kontratës, si dhe të garantojë që çdo pranim i mallit të aprovohet dhe dokumentohet në mënyrë të plotë, duke dëshmuar përputhshmërinë me kontratën.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B3 - Ridestnimi i mjeteve buxhetore të projekteve kapitale pa aprovim të Kuvendit Komunal

Gjetja Ligji Nr. 08-L-260 për ndarjet buxhetore për vitin 2024, neni 16, pika 11, përcakton që: "Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal"

Nga projekti "Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Devajë-Radivojc", për shkak të mungesës së fondeve për projektin përkatës, shuma prej 40,000€ është bartur tek projekti "Ndërtimi i ujësjellësit Ramjan-Novosellë", i cili është i aprovuar sipas Ligjit të Buxhetit. Ky ndryshim në ndarjen buxhetore është bërë me vendim të Kryetarit të Komunës, pa miratim të Kuvendit Komunal për ridestinimin e fondeve.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos përgjegjësisë së menaxhmentit të komunës për të zbatuar kërkesat e ligjit të buxhetit lidhur me ndryshimet buxhetore.

Ndikimi Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore të projekteve kapitale pa aprovim të Kuvendit Komunal ndikojnë në dobësimin e kontrollit buxhetor dhe të procesit të vendimmarrjes, si dhe në rrezikun e përdorimit të fondeve publike jashtë autorizimeve të miratuara, duke cënuar transparencën dhe rregullsinë në menaxhimin e buxhetit.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë se për çdo ndryshim në shumat buxhetore të projekteve të aprovuara në ligjin e buxhetit, të marrë paraprakisht aprovimin e Kuvendit Komunal.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B4 - Mospagesa e faturave brenda afateve ligjore

Gjetja Sipas Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), neni 39.1 përcakton se “Zyrtari Kryesor Financiar i organizates buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhet brenda tridhjet (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore”.

Gjatë auditimit është evidentuar se në 26 fatura në vlerë prej 834,857€, nuk ishin paguar sipas afatit kohorë të përcaktuar me legjislacionin në fuqi, përderisa vonesat e pagesës ishin deri në 405 ditë pas afatit 30 ditor.

Për më tepër, në listën e obligimeve të papaguara të raportuara në pasqyrat financiare vjetore, komuna ka 128 fatura në vlerë totale 361,205€, të cilat sipas datës së protokollit të pranimit të faturës kanë kaluar afatin ligjor të pagesës dhe kanë vonesa deri në 461 ditë.

Mospagesa e faturave brenda afateve ligjore kishte ndodhur si pasojë e mungesës së mjeteve financiare, e shkaktuar nga ekzekutimi i pagesave gjyqësore/përmbartimore nga kode ekonomike të planifikuara për destinime tjera, si dhe nga vonesat në kompletimin e lëndëve përkatëse.

Ndikimi Mos respektimi i afatit për pagesën e faturave mund ta ekspozojë komunën ndaj padive nga operatorët ekonomikë, duke rezultuar në shpenzime shtesë gjyqësore dhe përmbartimore, si dhe në krijimin e obligimeve financiare për vitet pasuese.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë planifikimin dhe menaxhim më të mirë të rrjedhës së mjeteve financiare dhe respektim të afateve ligjore të pagesave, si dhe duke përsheptuar procedurat e trajtimit të faturave për të shmangur vonesat në pagesa dhe krijimin e obligimeve dhe shpenzimeve shtesë për Komunën.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A4 - Mos kryerja e inventarizimit të pasurive jo financiare

Gjetja Sipas neneve 18 dhe 19 të Rregullores për menaxhimin e pasurisë jo

financiare, organizata buxhetore duhet të kryejë së paku një herë në vit inventarizimin e plotë të pasurisë jo financiare përmes komisionit të emëruar, duke verifikuar gjendjen fizike dhe duke reflektuar çdo ndryshim në regjistrat e pasurisë dhe kontabilitetit.

Komuna nuk kishte formuar komisionin për realizimin e inventarizimit vjetor të pasurisë jo financiare, në përputhje me kërkesat ligjore. Rrjedhimisht, si rezultat i mos inventarizimit të pasurive jo financiare, komuna nuk kishte bërë as krahasimin dhe reflektimin e ndryshimeve eventuale në regjistrat e pasurisë dhe evidencat kontabël.

Kjo ka ndodhur nga pakujdesia në zbatimin e procedurave të përcaktuara për inventarizimin e pasurisë jo financiare dhe mos kujdesit të duhur nga zyrtarët përgjegjës.

Ndikimi Mungesa e inventarizimit dhe mospërditësimi i regjistrave rrit rrezikun e paraqitjes jo të saktë të pasurisë jo financiare në evidencat kontabël dhe pamundëson identifikimin me kohë të diferencave, dëmtimeve apo humbjeve të pasurisë.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë që inventarizimi i pasurisë jo financiare të kryhet së paku një herë në vit në përputhje me kërkesat ligjore, përmes komisionit të emëruar, dhe që çdo ndryshim i konstatuar gjatë inventarizimit të evidentohet me kohë dhe në mënyrë të saktë në regjistrat e pasurisë dhe në evidencat kontabël, e rrjedhimisht edhe raportimin e drejt të tyre në pasqyrat vjetore financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B5 - Realizimi i subvencionimit jo në përputhje me Rregulloren në fuqi dhe kriteret e përcaktuara në thirrjen publike

Gjetja Sipas Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 01-013/1706, në nenin 8, paragrafi 4 - "Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve mban procesverbal nga mbledhja, i cili duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit, përderisa paragrafi 5 thekson se ky Komision rekomandon Kryetarit të Komunës listën e përfutuesve të subvencioneve, në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike për ndarjen e subvencioneve."

Po ashtu, sipas të njëjtës rregullore, në nenin 12, paragrafi 3 përcaktohet se: "Shpallja publike duhet të qëndrojë e publikuar për së paku 15 ditë pune nga data e publikimit."

Ndërsa, në nenin 20, paragrafët 1 dhe 2 përcaktohen dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarjen e subvencioneve në bujqësi për personat fizikë dhe juridikë.

Me rastin e subvencionimit të fermerëve me mekanizëm bujqësor, është konstatuar se Komuna nuk ka respektuar Rregulloren për Ndarjen e Subvencioneve, pasi thirrja publike ka qenë e hapur për 10 ditë pune, ndërsa sipas rregullores kërkohet që ajo të jetë e hapur për së paku 15 ditë pune. Gjithashtu, në thirrjen publike nuk është përcaktuar si kriter dëshmia për pagesën e taksave komunale.

Për më tepër, nga analiza e vlerësimeve të fermerëve aplikues është evidentuar se Komisioni nuk ka bërë vlerësim në përputhje me kriteret e thirrjes publike për subvencionim, si në vijim:

- Në subvencionimin për furnizim me mekanizëm bujqësor “Motokultivator me freza”, dy fermer kanë përfituar mekanizëm bujqësor në vlerë prej 1,660€, të cilët nuk e kanë plotësuar kriterin për posedimin e së paku 0.2ha kultura të mbjella.
- Në subvencionimin për furnizim me mekanizëm bujqësor “Spërkatëse 400L”, dy fermer kanë përfituar mekanizëm bujqësor në vlerë prej 1,140€, të cilët nuk e kanë plotësuar kriterin për posedimin e së paku 3ha kultura të mbjella.

Kjo kishte ndodhur për shkak të zbatimit jo të plotë të kërkesave të rregullores për ndarjen e subvencioneve, mungesës së kontrolleve efektive të brendshme dhe mosverifikimit të mjaftueshëm të përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në thirrjen publike gjatë procesit të subvencionimit.

Ndikimi

Mos ndarja e subvencioneve në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, si dhe mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara në thirrjen publike gjatë procesit të subvencionimit, rrezikon transparencën dhe integritetin e procesit, duke ndikuar në përzgjedhjen jo të drejtë dhe jo të barabartë të përfituesve.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë që procesi i subvencionimit të zhvillohet në përputhje të plotë me dispozitat e Rregullores në fuqi dhe kriteret e përcaktuara në thirrjen publike, duke garantuar që përfituesit të vlerësohen vetëm pas verifikimit të plotësisht të gjitha kushteve dhe dokumentacionit të kërkuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë në vitin 2025 ishte 3,519,448€, prej tyre ishin shpenzuar 3,470,564€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me mirëmbajtjen dhe riparimet, derivatet, mobiljet dhe pajisjet e zyrës, shërbimet e ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse, shërbimet e përfaqësimit, si dhe shërbimet komunale.

Çështja B6 - Mos përdorimi i sistemit të e-prokurimit për modulën e kontratave

Gjetja Neni 81 i LPP përcakton se autoritet kontraktuese duhet që si pjesë e përgatitjes së aktivitetit të prokurimit të prodhojnë një plan të menaxhimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet e aspekteve organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore të menaxhimit të kontratave. Plani i menaxhimit duhet të jetë i rënë dakord midis palëve të kontratës dhe të nënshkruhet nga ana e tyre para inicimit të zbatimit të kontratës. Ndërsa, sipas nenit 70 të Rregullores për Prokurim Publik nr.001/2022, të gjithë zyrtarët/personat e caktuar/emëruar si menaxherë të kontratës si nga ana e AK dhe OE duhet të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave në pajtim me manualët për përdorim të modulit për menaxhimin e kontratës. Gjithashtu, vlerësimi i përformacës së kontraktuesve do të bëhet: i) në sistem të prokurimit elektronik nëpërmejt modulit për vlerësim të përformancës së kontraktuesve; ii) nga menaxherët e kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, dhe iii) në pajtim me manualët për përdorim të modulit për vlerësimin të përformacës së kontraktuesve.

Gjatë auditimit kemi evidentuar se në pesë raste nuk ishin vendosur planet e menaxhimit të kontratave në platformën elektronike të prokurimit publik dhe kontratat nuk menaxhohen përmes moduleve përkatëse të e-prokurimit. Po ashtu, procesi i vlerësimit të kontratave nuk zhvillohej përmes platformës elektronike të prokurimit publik.

Mangësitë e identifikuara kanë ardhur si pasojë e mungesës së trajnimit të personelit përgjegjës dhe kujdesit të pamjaftueshëm në trajtimin e kërkesave ligjore.

Ndikimi Mos vendosja e planeve të menaxhimit të kontratave, mos shfrytëzimi i modulit për menaxhimin e kontratës dhe vlerësimin e përformacës së kontraktuesve përmes sistemit e-prokurimi, ndikon që kontratat të mos mbikëqyren në kohë reale.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të sigurojë që hartimi i planeve të menaxhimit të kontratave, menaxhimi i tyre dhe vlerësimi i performancës së

kontraktuesve të realizohen përmes platformës së e-prokurimit, në përputhje me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Komuna e Vitisë në PVF të vitit 2025 ka shpalosur pasuri kapitale (mbi 1,000€) në vlerë prej 94,062,474€, pasurive jokapitale (nën 1,000€) është 288,471€, si dhe e stoqeve në vlerë prej 37,034€.

Çështja B7 - Mangësi në raportimin, si dhe mos regjistrimi i blerjeve të pasurive jo kapitale në regjistrin e e-pasurisë

Gjetja Rregullorja MF Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo financiare në Organizatat Buxhetore, neni 6, paragrafi 3, përcakton që: "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria".

Pasuritë jo kapitale të prezantuara në Pasqyrat Financiare Vjetore ishin nënvlerësuar për 5,153€, krahasuar me listën analitike nga raporti i pasurive jo kapitale nën 1,000€. Për më tepër, gjatë auditimit kemi evidentuar se tri pasuri jo kapitale në vlerë 1,280€, nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive, përkatësisht në sistemin e-pasuria.

Kjo kishte ndodhur si mungesë e funksionimit efektiv të kontrollit të brendshëm, si dhe mos plotësimit të kësaj pozite së zyrtarit për regjistrimin e pasurive jo kapitale nën 1,000€, nga shtatori deri në përfundimin e vitit, për shkak të pensionimit të personit.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurive jokapitale ndikon që vlera e pasurive të paraqitura në pasqyrat vjetor financiar të jetë e nënvlerësuar.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle efektive dhe komunikim mes drejtorive ashtu që pasuritë jo kapitale të regjistrohen dhe raportohen saktë dhe të plota në pasqyrat vjetor financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.3 Të arkëtueshmet

Komuna e Vitisë në PFV e vitit 2025 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 3,723,002€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë, lejet e biznesit, shfrytëzimi i pronës publike dhe qiraja e hapsirës publike.

Çështja B8 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Rregullorja e Ministrisë së Financave nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar përcakton se Organizatat Buxhetore (OB) duhet të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sipas nenit 16, organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të obliguara të mbajnë regjistra për të hyrat e mbledhura dhe për shumat e faturuara e të paarkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në Raportin Vjetor Financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të të hyrave.

Bazuar në konfirmimet e komunës dhe dëshmitë e auditimit, kemi identifikuar raste të mosreflektimit të pagesave të realizuara, si dhe mospërputhje në të dhënat e gjeneruara nga sistemi, çka tregon mangësi në administrimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave të llogarive të arkëtueshme të regjistrit të komunës. Nga 19 mostrat e testuara për tatimin në pronë, në 18 prej tyre janë identifikuar diferenca në vlerë prej 17,529 €, ndërmjet vlerave të prezantuara nga komuna dhe evidencave të regjistruara në sistem.

Gjithashtu, mospërputhje ndërmjet vlerave të prezantuara dhe shënimeve kontabël janë vërejtur edhe te llogaritë e arkëtueshme nga të hyrat e shfrytëzimit të pronës publike, pasi që në tre nga gjashtë mostra të testuara, janë identifikuar mospërputhje në vlerë totale prej 2,106€.

Për më tepër, regjistri i llogarive të arkëtueshme përfshin edhe borxhe nga vitet e kaluara, për të cilat Komuna nuk ka arritur të dëshmojë se për të gjitha rastet janë ndërmarrë procedura për inkasim e tyre.

Mangësitë e identifikuara janë si rezultat i problemeve të vazhdueshme në funksionimin e sistemit “PROTAX”, ku janë vërejtur vazhdimisht gabime në paraqitjen e gjendjes së borxhit për tatimpaguesit. Përveç kësaj, llogaritë për të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike mbahen në Excel dhe nuk janë azhurnuar në mënyrë adekuate, duke rritur rrezikun e pasqyrimin jo të saktë të gjendjes së arkëtueshmeve.

Ndikimi

Problemet në funksionimin e sistemit mund të ndikojnë që llogaritë e arkëtueshme të mos prezantohen saktë në PVF. Ndërsa përdorimi i aplikacioneve manual dhe mos arkëtimi i borxheve ndikon që komuna të mos realizoj projektet nga të hyrat vetanake. Rrjedhimisht,

kjo mund të ndikojë në arritjen e objektivave të komunës.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle më efektive, në mënyrë që evidentimi, analizimi dhe pasqyrimi i llogarive të arkëtueshme të jetë i saktë dhe marrjen e veprimeve për mbledhjen e borxheve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.4 Funksioni i auditimit të brendshëm

Komuna e Vitisë ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NJAB), që përbëhet nga tre anëtarë. Komiteti i Auditimit është i themeluar. Aktivitetet e auditimit realizohen bazuar në planin strategjik si dhe planin vjetorë të auditimit. Gjatë vitit 2025 NJAB ka kryer të gjitha auditimet e planifikuara në planin vjetor të auditimit.

Çështja A5 - Mosrealizim i përgjegjësi të Komitetit të Auditimit, si rezultat i mosmbajtjes së takimeve sipas kërkesave ligjore

Gjetja

Sipas Udhëzuesit Administrative MR-NR. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektin e sektorit Publik, neni 8, Takimet e Komitetit të Auditimit mbahen së paku katër herë në vit, me qëllim të kryerjes së përgjegjësi sa i përket: këshillimit të udhëheqësit të subjektit të sektorit publik për kontrollin e brendshëm, menaxhimin e rrezikut dhe auditimin, sigurimin e bashkëpunim ndërmjet menaxhmentit, auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, miratimin e planeve dhe raporteve të auditimit, zbatimin e rekomandimeve dhe raportimeve, si dhe shqyrtimin e pasqyrave financiare dhe raportit vjetorë të auditimit.

Komuna e Vitisë më 01.07.2024 ka themeluar Komitetin e Auditimit në përbërje prej tre anëtarëve me mandat tre vjeçarë, megjithatë gjatë vitit nuk është mbajtur asnjë takim e rrjedhimisht nuk janë përmbushur edhe obligimet ligjore të parapara sipas legjislacionit në fuqi.

Mos mbajtja e takimeve të Komitetit të Auditimit kishte ndodhur nga pakujdesia në respektimin e kërkesave ligjore si dhe përgjegjësi të përcaktuara me rastin e emërimit.

Ndikimi

Mosfunksionimi i Komitetit të Auditimit ka ndikuar në mbikëqyrjen e kontrollit të brendshëm, mos shqyrtimin dhe aprovimin e raporteve të auditimit, mungesën e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit, si dhe në uljen e efektivitetit të menaxhimit të rrezikut dhe shqyrtimit të pasqyrave dhe raporteve financiare të Komunes.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e rregullt të Komitetit të Auditimit në Komunë, përmes mbajtjes së takimeve periodike sipas kërkesave ligjore, me qëllim të forcimit të mbikëqyrjes së kontrollit të brendshëm, aprovimit të raporteve të auditimit, monitorimit të zbatimit të rekomandimeve dhe përmirësimit të menaxhimit të rrezikut dhe proceseve financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	17,945,622	19,090,932	18,883,721	19,775,753	17,059,276
Grante Qeveritare – Buxheti	16,675,495	17,027,015	16,990,661	17,912,607	15,257,344
Të bartura nga viti i kaluar	0	230,521	225,467	449,095	340,713
Të hyrat vetanake	1,270,127	1,270,127	1,268,404	1,008,013	990,630
Donacionet vendore	0	78,238	75,655	85,860	74,181
Donacionet e jashtme	0	485,031	323,533	320,179	396,408

Buxheti final i Komunës së Vitisë është më i lartë se buxheti fillestar për 1,145,310€ apo 6.38%. Kjo rritje e buxhetit është rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje buxhetore në vlerë prej 351,520€, përfshirjes së të hyrave të bartura nga vitet paraprak në vlerë prej 230,521€ dhe donacioneve në vlerë prej 563,269€ në buxhet final.

Në vitin 2025, Komuna ka shpenzuar rreth 98% të buxhetit final ose 18,883,721€, me një rënie prej 4.72%% në raport me vitin e kaluar. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Vlen të theksohet se Thesari nga kategori të ndryshme ekonomike sipas vendimeve përmbartimore/gjyqësore kishte realizuar pagesa në vlerë 2,817,928€, për obligime të dala nga kontrata kolektive dhe për operatorë ekonomik.

Komuna kishte lëvizje buxhetore nëpër kategori. Megjithatë, të gjitha lëvizjet/ndryshimet ishin të mbështetura me vendime përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	17,945,622	19,090,932	18,883,721	19,775,753	17,059,276

Pagat dhe mëditjet	9,887,124	10,270,452	10,265,172	11,936,439	9,096,106
Mallrat dhe shërbimet	3,172,919	3,219,448	3,177,362	2,941,435	2,569,043
Komunalitë	300,000	300,000	293,202	281,606	317,043
Subvencionet dhe transferet	720,000	855,947	846,348	775,930	769,962
Investimet Kapitale	3,865,579	4,445,084	4,301,637	3,840,342	4,307,122

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 383,328€. Buxheti final përbehet nga granti qeveritar në vlerë prej 10,238,644€ dhe donacionet e jashtme prej 31,808€. Për përudhen janar – dhjetor 2025 realizimi i buxhetit është 10,270,452€ apo 96.3% e buxhetit final;


- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 46,529€. Pjesa më e madhe e këtij buxhetit përbëhet nga granti qeveritar prej 2,843,828€, të hyrave vetanake prej 329,091€, të hyrave vetanake të bartura prej 5,063€ dhe donacionet në vlerë prej 41,466€. Deri në fund të vitit 2025 realizimi i buxhetit ishte 3,171,362€ apo 98.7% e buxhetit final. Përveç vlera prej 776,609€ është ekzekutuar përmes vendimeve gjyqësore për kontratë kolektive dhe paga jubilarë;

- Buxheti final për shpenzime komunale në krahasim me buxhetin fillestar nuk kishte ndryshime. Ky buxhet përbëhet nga granti qeveritar në vlerë prej 300,000€. Deri në fund të vitit realizimi i buxhetit ishte 293,202€ apo 97.7% e buxhetit final. Vlen të theksohet se vlera prej 102,837€ është ekzekutuar përmes vendimeve gjyqësore për kontratë kolektive dhe paga jubilarë;

- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 135,947€. Ky buxhet përbëhet nga fondi qeveritar prej 500,000€, të hyrave vetanake prej 220,000€, të hyrave vetanake të bartura prej 4,868€ dhe grantit të donacioneve prej 131,079€. Realizimi i buxhetit në fund të vitit ishte 293,202€ apo 98.9% e buxhetit final. Vlora prej 203,484€ është ekzekutuar përmes vendimeve gjyqësore për kontratë kolektive dhe paga jubilarë; dhe

- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje në vlerë prej 579,505€. Ky buxhet përbehet nga fondi qeveritar prej 3,144,543€, të hyrave vetanake prej 721,036€, të hyrave vetanake të bartura 220,589€ dhe donacioneve prej 358,915€. Deri në fund të vitit Komuna kishte arritur të shpenzoj vetëm 4,301,637€ apo 96.8% e buxhetit. Për më tepër, vlora prej 1,735,002€ është ekzekutuar përmes vendimeve gjyqësore për kontratë kolektive, paga jubilarë dhe operatorë ekonomik nga kategoria e investimeve kapitale.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Vitisë në vitin 2025 ishin në vlerë prej 1,273,789€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për leje ndërtimi, participimet, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike, etj. Për vitin 2025, Komuna kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 1,270,127€. Në krahasim me vitin e kaluar, niveli i inkasimit të të hyrave ka shënuar rritje prej 336,504€ apo rreth 35.9%.

Përveç kësaj, të hyrat nga gjobat në trafik dhe gjobat nga gjykatat ishin në shumë prej 436,302€, të cilat grumbullohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), dhe më pas alokohen për komunën për shpenzim. Këto të hyra nuk janë përfshirë në tabelën e mëposhtme, për arsye se planifikohen dhe realizohen nga ministritë përkatëse.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	1,270,127	1,270,127	1,273,789	937,285	1,232,853
Të hyrat tatimore	566,265	566,265	675,698	450,548	746,135
Të hyrat jo tatimore	703,862	703,862	593,916	486,303	486,718
Të hyrat tjera	0	0	4,175	434	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PVF-të të vitit 2024 të Komunës së Vitisë ka rezultuar 12 rekomandime kryesore. Komuna e Vitisë nuk kishte përgatitur një Plan Veprimi për zbatimin e rekomandimeve të dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, tri rekomandime janë zbatuar, një rekomandim nuk është më i aplikueshëm, ndërsa tetë rekomandime nuk janë zbatuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve në ndarjen adekuate të buxhetit në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në raportin vjetor financiar.	Gjatë vitit 2025 keqklasifikimi ishte në vlerë më të lartë se vitin paraprak dhe ishte i përfshirë në katër kategori ekonomike.	Nuk është adresuar
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle efektive dhe komunikim mes drejtorive ashtu që pasuritë jo kapitale regjistrohen dhe raportohen saktë dhe të plota në raportin vjetor financiar.	Gjatë auditimit është vërtetuar se edhe këtë vit Komuna nuk ka arritur të bëjë raportimin e të gjitha pasurive	Nuk është adresuar

			jo kapitale në sistemin e-pasuria, si dhe raportimin e saktë të tyre.	
3.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se tatimi në pronë nuk aplikohet për pronat e institucioneve publike, për të mundësuar raportim të saktë të llogarive të arkëtueshme në raportin vjetor financiar.	Gjatë auditimit edhe këtë vit nuk ka qenë e mundur të bëhet verifikimi i saktësisë së llogarive të arkëtueshme të prezantuara në Pasqyrat Financiare Vjetore.	Nuk është adresuar
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se për çdo ndryshim në shumat buxhetore të projekteve të aprovuara në ligjin e buxhetit, të marrë paraprakisht aprovimin e Kuvendit Komunal.	Nga testimi i mostrave është evidentuar se Komuna kishte bërë ndryshimet në shumat e ndara buxhetore të projekteve kapitale pa aprovim të Kuvendit Komunal.	Nuk është adresuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë fonde të mjaftueshme të mjeteve në mënyrë që të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda 30 ditëve pas pranimi të tyre.	Gjatë auditimit është verifikuar se Komuna vazhdon të ketë vonesa në pagesën e faturave pas afatit të përcaktuar ligjor.	Nuk është adresuar
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë respektimin në tërësi të kriterëve të vendosura në thirrjen publike për subvencionim me rastin e vlerësimit të përfituesve dhe se marrëveshjet e subvencionimit nënshkruhen vetëm pasi të jenë plotësuar të gjitha këto kriterë.	Nga testimi i subvencionimeve të vitit aktual janë evidentuar papajtueshmëri në procedura të subvencionimit.	Nuk është adresuar
7.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e angazhimit të stafit për shërbime të veçanta të respektohen kriteret sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik.	Gjatë auditimit nuk kemi identifikuar se Komuna gjatë vitit 2025 kishte angazhuar	I zbatuar

			punonjës me kontrata për shërbime të veçanta pa procedura ligjore	
8.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurohet që para inicimit të procedurave të prokurimit për projektet kapitale, për të njëjtat ka fonde të mjaftueshme buxhetore të parapara në ligjin e buxhetit dhe kornizën afatmesme të shpenzimeve.	Nga testimet nuk janë identifikuar çështje të inicimit të procedurave pa fonde të mjaftueshme të parapara me ligjin e buxhetit.	I zbatuar
9.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave përdorin modulën përkatës në sistemin e prokurimit publik për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës sipas rregullave përkatëse.	Gjatë auditimit të mostrave të vitit aktual kemi evidentuar se moduli i kontratave tek e-prokurimi Komuna nuk e aplikon në të gjitha rastet.	Nuk është adresuar
10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se para inicimit të projekteve për punë, të përmbushen kushtet e realizimit projektit si në aspektin teknik ashtu edhe në aspektin financiar, përmes hartimit të mirëfilltë të projekteve dhe sigurimit të mjaftueshëm të buxhetit në mënyrë që punët të realizohen sipas planit.	Gjatë auditimit të mostrave të vitit aktual si dhe verifikimit të rasteve të identifikuara të vitit paraprak nuk kemi identifikuar vonesa në realizimin e projekteve kapitale.	I zbatuar
11.	Pasuritë	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe regjistrimin e tyre si pasuri në përdorim në mënyrë që të njëjtat të raportohen drejtë dhe saktë.	Nga verifikimi i rasteve të vitit paraprak dhe auditimit të mostrave të vitit aktual është evidentuar se Komuna vazhdon të mbajë pasuri si investime në vijim përkundër faktit se të	Nuk është adresuar

			njejtat janë në përdorim.	
12.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore.	Menaxhimi jo efikas i llogarive të arkëtueshme është i ndërlidhur në mënyrë direkte me saktësinë e llogarive të arkëtueshme, andaj kjo çështje vitin aktual është trajtuar tek Prezantim jo i saktë i llogarive të arkëtueshme.	Nuk është i aplikueshëm më

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Mehmet Mucaj, Drejtor i Auditimit



Xhemile Berisha - Hoti, Udhëheqëse e ekipit



Lindita Ajeti, Anëtare e ekipit



Alban Shatri, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Sqarim rreth Letër Konfirmimit

Pas përcjelljes së draft raportit të auditimit të Komunës së Vitisë për komente, e njëjta nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor 15 ditë për komente. Ekipi i auditimit të ZKA në vazhdimësi ka komunikuar me personat përgjegjës në kuadër të komunës për ta njoftuar në lidhje me tejkalimin e afatit, por Komuna nuk është përgjigjur edhe më tutje.

Në mungesë të përgjigjes, ZKA ka publikuar raportin e auditimit të Komunës së Vitisë për vitin 2025 pa letër konfirmim apo komente.

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.